



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 15/04/2022 Ref.: 473/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), si dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 97-të, të mbajtur më 05 Prill 2022, mori:

## V E N D I M

- I. Nuk akreditohet programi i studimit i Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Prishtinës ‘Hasan Prishtina’:
  - I. Matematikë, MSc, 120 ECTS.
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## A r s y e t i m i

I. Universiteti i Prishtinës ‘Hasan Prishtina’ ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim e programit të studimit me stafin akademik si në tabelën e mëposhtme:

<i>Nr.</i>	<i>Programi i studimit</i>	<i>Bartësit e programit</i>
I	Matematikë, MSc, 120 ECTS Ri akreditim	Bujar Fejzullahu Edmond Aliaga

Vizita është organizuar më 21.02.2022, me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Peeter Normak dhe Laura Palac.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportin e vlerësimit, dhe për këtë program bazuar në fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimin si në vijim:


1. Nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht dy (2) fusha, dhe pjesërisht pesë (5) fusha.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 97 të mbajtur më 05.04.2022 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit të Prishtinës ‘Hasan Prishtina’ dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, si dhe në rekomandimin përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Prishtinës ‘Hasan Prishtina’;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.

  
Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi  
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

